



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVË	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia/Unit Org/Unit	50-02
No i Fajës/ Pr. Stranica/ No. Pages	-06-
No i Prot. Prot. No.	6526-2/24
Datë/ Date	16-06-25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	05.05.2025
REFERENC-Ë:	24/6526/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Princi Compnay" shpk, Harilaq- Fushë Kosovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 24/6526/666/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Princi Compnay" shpk, për Fabrikën e Seleksionimit dhe Ambalazhimit të Plastikës, Letrës, Qelqit, Metaleve si dhe Djegien e Mbeturinave Medicinale - Barnave me Afat të Skaduar (shtimi i kodeve) në Harilaq- Fushë Kosovë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Princi Compnay" shpk - pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për Fabrikën e Seleksionimit dhe Ambalazhimit të Plastikës, Letrës, Qelqit, Metaleve si dhe Djegien e Mbeturinave Medicinale - Barnave me Afat të Skaduar (shtimi i kodeve) në ngastren kadastrale me Nr. P-72514003-00779-10 në ZK Harilaq- Fushë Kosovë, për kodet:

Tabelave e kodeve shitesë të kërkuara për pëlqim					
01 04 13	09 01 08	15 02 02*	17 04 01	18 02 05*	
02 01 04	09 01 10	15 02 03	17 04 02	18 02 06	20 01 19*
02 01 10	10 03 05	16 01 03	17 04 03	18 02 07*	20 01 27*
02 03	15 01	16 01 07	17 04 05	19 12 01	20 01 28
02 03 99	15 01 01	16 01 19	17 04 06	19 12 02	20 01 29*
03 01	15 01 02	16 01 20	17 04 07	19 12 03	20 01 30
03 01 01	15 01 03	16 04 02*	17 06 01*	19 12 04	20 01 31*
03 03 08	15 01 04	16 06 01*	17 06 03*	19 12 05	20 01 32
04 01	15 01 05	16 06 04	17 06 04	19 12 06*	20 01 33*
04 01 01	15 01 06	16 06 05	17 06 05*	19 12 07	20 01 34
04 01 09	15 01 07	16 08 01	18 01 02	19 12 08	20 01 35*
04 02 09	15 01 09	17 02 01	18 01 03 *	20 01 01	20 01 36
07 02 13	15 01 10*	17 02 02	18 01 06*	20 01 02	20 01 39
09 01 06*	15 01 11*	17 02 03	18 01 08*	20 01 10	20 01 40
09 01 07	15 02	17 02 04 *	18 02 02 *	20 01 11	

Pëlqim Mjedisor lëshohet nën kushtet si vijon:

- Të bëhet izolimi i platos ku do të vendosen mbeturinat e plastikes, letrës, metaleve, qelqit , mbeturinave urbane, gomave, vajrave, mbetjeve medicinale si dhe barnave te skaduara,
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku do të vendosen pajisjet për prodhimin e asfaltit si dhe pompat për thithjen apo dërgimin e karburanteve djegëse dhe bitumenit, si dhe gjeneratorët.
- Të vendoset sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave industriale, ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike nga sipërfaqet operationale (seperatorin dhe gropën septike), para shkarkimit të tyre.
- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për përcjelljen e pluhurit dhe gazrave në vendet lidhëse, të izolohehen të gjitha pikat gjeneruese të pluhurit.

- Të bahet monitorimi i emisioneve të pluhurit, gazrave dhe ujërave që shkarkohen në mjedis.
- Rezultatet e kryera laboratorike të i raportohen MMPHI, në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Të vendosen pajisjet për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngëta.
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi dhe rregullimi i rrethojës së terenit afër bazën e asfaltit .
- Të bëhet plani për marrjen e masave rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë fazës së ndërtimit, zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të projektit.
- Të bëhet trajnimi i punëtorëve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit
- Aplikanti përpos kushteve të lartë cekura të i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr.04/L-147 ,neni 48, pika 1 dhe 1.3 , me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e kompanisë “Princi Company ,Prishtinë në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania “Princi Compnay” shpk - për Fabrikën e Seleksionimit dhe Ambalazhimit të Plastikës, Letrës, Qelqit, Metaleve si dhe Djegien e Mbeturinave Medicinale - Barnave me Afat të Skaduar (shtimi i kodeve) në ngastren kadastrale me Nr. P-72514003-00779-10 në ZK Harilaq- Fushë Kosovë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimt e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/6526/1 - ZSP/ /25 datë: 05.05.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VNM*
3. *Inspektoratit*
4. *Kabinetit të Ministrit*
5. *Komunës së Fushë Kosovës*
6. *Divizionit për komunikim me publikun*
7. *Arkivit të MMPHI*

Izedin Bytyqi
Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI



2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.